



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Mbledhja nr. 73

Prishtinë, më 12.04.2013, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Rexhep Selmi, Goran Marinković, Fatmir Xhelili, Anton Quni, Vjollca Krasniqi, Ganimete Musliu, Rasim Demiri dhe Danush Ademi.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku, Zarife Aliu dhe Antigona Ibraj.

Mbledhjen e kryesoi: Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Komisionit të mbajtura më 22.03.2013 dhe 26.03.2013;
3. Situata aktuale e sigurisë në Republikën e Kosovës;
4. Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit Nr. 03/L-036 për Inspektoratin Policor të Kosovës;
5. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari i Komisionit- E filloi takimin e radhës së Komisionit duke kërkuar nga anëtarët pajtimin e tyre për miratimin e rendit të ditës.

Rendi i ditës u aprovua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Komisionit të mbajtura më 22.03.2013 dhe 26.03.2013

Kryetari i Komisionit- Konstatoi miratimin e procesverbaleve të mbledhjes të Komisionit, të mbajtura më **22.03.2013 dhe 26.03.2013.**

Procesverbalet u aprovuan pa ndryshime.

3. Situata aktuale e sigurisë në Republikën e Kosovës

Kryetari i Komisionit- Foli për Situatën aktuale e sigurisë në Republikën e Kosovës. Qysh në fillim po merremi me një çështje e cila është jashtëzakonisht e rëndësishme për punën e Komisionit tonë, për veprimin e institucioneve për mbajtjen e Rendit dhe të Ligjit në Republikën e Kosovës. Konsideroj se Siguria në Kosovë është e brishtë për arsyet e njohura të mospranimit të Marrëveshjes së Serbisë në Bisedimet Kosovë-Serbi që janë duke u udhëhequr nga Bashkimi Evropian, e që në të vërtetë mospranimi i Marrëveshjes i obligon institucionet tona të Sigurisë të jenë në nivel të detyrës së tyre për marrje të përgjegjësisë rreth situatës në përgjithësi. Po ashtu, në bazë të obligimeve që kemi për Mbikëqyrjen e institucioneve, siç është Ministria e Punëve të Brendshme, Forca e Sigurisë së Kosovës dhe mekanizmat e tjerë të Sigurisë në Kosovë, andaj e konsideroj se obligim i Delegacionit të Kosovës është ta mbajë qëndrimin në bazë të Ligjeve dhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Palët serbe kanë tendencë të kenë më shumë kompetenca në gjyqësi, siguri, në çështjet politike në veri dhe vendosjen e institucioneve atje, madje në një paralelizëm të theksuar për ta ndryshuar gjendjen konstituive në Republikën e Kosovës. Andaj kërkoj që edhe ju, si anëtarë të Komisionit, të angazhoheni që t'i japim rekomandimet tona për institucionet e Sigurisë, në mënyrë që të ndërmarrin masa në ruajtjen e stabilitetit dhe në mbajtjen e gjendjes së Sigurisë, Rendit dhe të Ligjit në Kosovë.

Rexhep Selimi- Për fat të keq nuk është risi, e as lajm që situata e Sigurisë në Kosovë është e keqe dhe e tensionuar. Ndër shumë faktorë të tjerë po vazhdojnë të mbeten tre faktorë kryesorë të cilët po e rrezikojnë dhe përkeqësojnë situatën e Sigurisë në Kosovë. Një ndër faktorët determinues të përkeqësimit të kësaj situatë po vazhdon të mbetet Serbia, e cila po vazhdon të jetë prezent në kufijtë e Kosovës dhe brenda saj, e jo vetëm në atë pjesë ku tash e disa kohë Qeveria e Kosovës nuk e kontrollon më, por edhe pjesët tjera të kufirit të Kosovës dhe të Shqipërisë. Ilustrimet e fundit janë arrestimet e qytetarëve të Kosovës nga xhandarmëria serbe, futja e xhandarmërisë serbe brenda territorit të Republikës së Kosovës etj., po vazhdojnë të mbeten një nga faktorët që e përkeqësojnë situatën e Sigurisë. Po ashtu edhe strukturat ilegale të Sigurisë së Serbisë në Kosovë po vazhdojnë ta mbajnë situatën, jo thjeshtë të përkeqësuar e ndërlikuar, por shumë të tensionuar. Shpesh kemi dëgjuar se situata është stabile dhe dua të konfirmoj se edhe kur është stabile, situata e sigurisë është e keqe. Sa herë që lëvizë kjo situatë shkon drejt përkeqësimit dhe për fat të keq këtë përkeqësim po ua mundëson edhe menaxhimi keq i Sektorit të Sigurisë dhe keq menaxhimi i MPB nga ana e Qeverisë së Kosovës. Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së sikur po bënë edhe sot, ka vazhduar ta bëjë punën e vetë, ndonjëherë është dukur si ndërhyrje, ose presion

por nuk ka qenë asnjëherë kjo, por qëllimi është që të kontribuoj në Sigurinë e Vendit. Megjithatë nuk po duket që kemi arritur efektin e duhur që Sektorin e Sigurisë ta përmirësojmë duke e mbikëqyrë punën e keqe të MPB. Neve na mbetet që të konstatojmë që Situata e Sigurisë në Kosovë është e keqe dhe nuk po duket që ka ndonjë përmirësim, prandaj nuk është më në dorën e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, që ta përmirësojë këtë situatë para se Qeveria të ndërmarrë masa të duhura që ta bëjë një gjë të tillë. Komisioni ka ngritur këtë çështje duke pasur për qëllim ta ndërgjegjësojë Qeverinë të marrë masa, që të jetë dikasteri që do të duhet të ishte prodhues i Sigurisë në vend, e jo prodhues i skandaleve, ashtu siç ka ndodhur. Andaj Qeveria e Kosovës duhet të merret me shkarkimin e Ministrit të Brendshëm, si një ndër hapat drejt përmirësimit të situatës së Sigurisë në Kosovë.

Anton Quni- Gjatë bisedimeve të Marrëveshjes mes Prishtinës dhe Beogradit në Bruksel, qytetarët e Kosovës u janë nënshtruar një propagande të fuqishme, si pjesë e luftës speciale, dhe kryesisht mediat tona u janë referuar mediave të Beogradit të cilat kanë referuar se Qeveria, Policia, FSK-ja po përgatisin një operacion të përmasave të mëdha për ndërhyrje në Veri të Mitrovicës. Kjo propagandë rrezikon dhe përkeqëson edhe më shumë gjendjen në cilësimin e raporteve ndëretnike. Ne, si Komision, duhet t'ua rikujtojmë Qeverisë dhe gjitha institucioneve që kanë të drejtën legjitime dhe të këmbëngulin në kërkesën e tyre për zbatimin e Marrëveshjes Tekniko-Ushtarake të Kumanovës e cila është nënshkruar më 10 qershor '99, ku pala serbe, si palë humbëse është obliguar që t'i tërheqë të gjitha forcat ushtarake, policore paramilitare dhe administratën. Kemi të gjitha faktet se strukturat legale të Serbisë të cilat ilegalisht gjenden brenda territorit të Kosovës, duhet të jenë objekt interesimi i KFOR-it, EULEX-it dhe i politikave të qarqeve politiko-ushtarake, me prioritet ato të NATO-s të cilat kanë marrë përsipër që këtë Marrëveshje ta zbatojnë në tërësi. Andaj edhe kërkesa ime është që ne, si Komision, t'ia rikujtojmë edhe një herë Qeverisë se e kanë këtë të drejtë legjitime, natyrisht duke asistuar edhe me forcat tona vetanake që ne i posedojmë si Ministri e Punëve të Brendshme dhe institucione e tjera.

Fatmir Xhelili- Fillimisht kjo pikë e rendit të ditës, d.m.th. Situata e Sigurisë në Kosovë ka kuptim si pikë, por nuk po e shoh të arsyeshme diskutimin e kësaj pike pa pasur një Raport prej organeve zyrtare për situatën momentale të Sigurisë në Kosovë në të cilën duhet të bazohemi, sepse i kanë ndërtuar disa segmente dhe mekanizma që janë përgjegjës dhe obligues edhe për situatën e Sigurisë, por janë obligues edhe në raportimin në bazë të informacioneve reale që i kanë prej instrumenteve zyrtare për të përcaktuar, vlerësuar, analizuar dhe parashikuar situatën e Sigurisë. Kjo është e para.

E dyta është se jemi në proces të bisedimeve dhe shpesh disa njerëz për qëllime politike të brendshme, ose për shkak të mosnjohjes së situatës shfaqin pesimizëm në relacion me ardhmërinë e shtetit tonë, por nëse kthehemi në retrospektivë dhe analogji dhe shikojmë situatat që nga Rambujea edhe situatat që na janë dukur të pazgjidhshme, çdo herë ekipi i Kosovës ka gjetur zgjedhje dhe ka dalë nga ato situata si fitimtar. Gjegjësisht ka arritur edhe ta bindë faktorin ndërkombëtar, por edhe të tjerët për t'i fituar Kosova të drejtat të cilat i kanë takuar, e që i janë cenuar për një periudhë të gjatë kohore. Edhe tani jemi në proces e sipër të bisedimeve, jemi duke pritur produktin e këtyre bisedimeve për të vlerësuar se a janë të mira, ose nuk janë dhe cilat do të jenë produktet e punës. Sa i përket

situatës së Sigurisë në Kosovë, unë nuk e shoh aq të rrezikshme e aq të ndjerë. Situata e Sigurisë në Kosovë është stabile me incidente të kohëpaskohshme, që kanë qenë edhe të parashikueshme në këtë periudhë kohore që do të zhvillohen negociatat. Ne jemi partnerë me faktor strategjik, si BE-në dhe SHBA-në, dhe këtu e kemi edhe misionin e EULEX-it. Prandaj masat, veprimet dhe aktivitetet të cilat duhet të ndërmerren për të përmirësuar situatën e Sigurisë, duhet të jenë të definuar edhe me këta partnerë. Ajo pjesë e Kosovës nuk është bërë problem tash, por ka ekzistuar këto 13 vjetët e fundit, por ndoshta edhe në 50 vitet e fundit, nëse nisemi pas Luftës së Dytë Botërore, se nëse e shohim hartën e Luftës së Dytë Botërore e shohim se e ka gjenezën shumë larg. Duke u bazuar në përkrahjen e faktorëve strategjikë dhe shteteve dashamirëse ndaj Kosovës, shteteve përcaktuese të politikës reale në Ballkan dhe synimi për me qenë nesër Ballkani i qetë, një Rajon i sigurt dhe një Rajon që i plotëson kriteret për të hyrë në BE. Duke u bazuar në vlerësimin tyre real të situatës, unë e shoh se edhe ky problem ka për t'u zgjidhur në favor të qytetarëve të Kosovës. Nuk është problem i lehtë dhe nuk është problem javor ose mujor, por është problem në një proces që vendos së paku për 50 vitet e ardhshme të Rajonit dhe nuk e kanë lehtë vendimmarrësit të cilët e kanë përgjegjësinë për këto negociata, me vetë faktin se Qeveria e Kosovës e ka edhe mandatin prej Kuvendit me negociatë. Dëshiroj që ky vlerësim të bëhet më vonë, sepse ende kemi zhvillime për të cilat presim që në ditët e ardhshme të dhënat do të ndryshojnë dhe ato gjithsesi se do të jenë në favor të Kosovës.

Goran Marinkovç- Kur flitet për situatën e sigurisë, unë duhet të shpreh shqetësimin në lidhje me disa incidente që kanë ndodhur kohëve të fundit, incidente këto të cilat vinë nga strukturat etnike, rasti i gjuajtjes së një lloj eksplozivi në shtëpinë e z. Zlatko Gjuriq në rajonin e Istogut, ku jeton me bashkëshorten e tij të komunitetit shqiptar. Rasti tjetër ka ndodhur dje në manastir, ku prapë ka pasur provokime etnike, këto janë incidente të cilat në Kosovë janë të rrezikshme dhe të cilat krijojnë tensione midis popujve. Kjo ndoshta nuk është çështje e madhe në këtë moment, mirëpo mund të them që për asnjë rast të tillë MPB nuk e ka gjetur ndonjë zgjidhje dhe mendoj që ne, si Komision, duhet të reagojmë. Siç dihet edhe jemi para një shtate që është mjaft e ndjeshme, sepse Kosova ndodhet në bisedime me Serbinë, prandaj do të duhej t'i mbikëqyrim rastet e tilla, ose tensionet e tjera që mund të ndodhin. Prandaj mendoj që mund të ndikojmë të ministri i MPB që të kërkojmë një efikasitet të policisë të ngritët në një nivel më të lartë.

Rexhep Selimi- Jam edhe një herë i shtyrë të ndërhyjë në vlerësimet e Komisionit mbi situatën e Sigurisë. Nuk mendoj se ka nevojë për njohuri të mëdha mbi situatën e Sigurisë kur gjendet vendi në këtë shtatë, sa që një pjesë e territorit është e ndaluar për qytetarët e pjesës tjetër të territorit dhe kjo nuk do shumë mend që ta njohësh, ose mos ta njohësh situatën e Sigurisë në këtë vend. Nuk mendoj se do të duhej prituri përfundimi i bisedimeve pastaj të shohim rezultatet për shkak se nuk do duhej të presim e pastaj të shohim, por duhet të shohim, pastaj të veprojmë. Ajo çfarë do të duhej të shohim është vlerësimi real i situatës së Sigurisë dhe masat reale për situatën e Sigurisë. Nuk më vjen mirë kur situata e Sigurisë në Kosovë vlerësohet me incidente të kohëpaskohshme, ashtu siç u vlerësua këtu. Situata e Sigurisë është më e ndërlikuar se sa me incidente të kohëpaskohshme dhe vlerësoj se rrënimi i stabilitetit në një pjesë që përfshinë një të katërtën e territorit të Republikës së Kosovës, pra ndërhyrja e drejtpërdrejtë në sovranitet

në një të katërtën e Republikës së Kosovës nuk është incident i kohëpaskohshëm i cili do ta bënte situatën e Sigurisë stabile. Nuk besoj se do të jetë e lehtë zgjidhja as tani dhe as pas përfundimit të bisedimeve, për shkak se nga këto bisedime nuk presim zgjidhje dhe përderisa nuk presim zgjidhje përkundrazi zgjidhja do të jetë e keqe. Kështu që dua të reagoj dhe një herë se situata nuk është stabile me incidente të kohëpaskohshme, por është shumë e rëndë sidomos në pjesën veriore të Republikës së Kosovës, ku unë, kolegët e mi dhe qytetarët e Kosovës nuk mund të shkojmë lirshëm atje dhe mendoj se ky vlerësim nuk është në përputhje me realitetin në fushën e Sigurisë.

Kryetari i Komisionit- Obligim i Komisionit është që të paraqes rekomandime, këshilla ose sugjerime Qeverisë në mënyrë që të jetë e kujdesshme në zbatimin e Ligjit dhe të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Për të rikujtuar këtë është kompromisi më i madh që është bërë në Kosovë, e që është drafti i Ahtisarit, i cili është rast unik në nivel të Rajonit dhe të Evropës për standardet e arritura për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve, e sidomos të minoriteteve. Vetëm dua t'ua rikujtoj nenin 42 të përgjegjësisë të Ligjit për Policinë dhe konsideroj se një sugjerim i tillë është i dobishëm edhe për Qeverinë e Kosovës edhe për ekipin që është në bisedime, sepse bisedimet janë në zhvillim e sipër edhe pas një mospranimi të Serbisë për marrëveshjen. Dua ta parafrazoj nenin 42: “Në komunat ku komuniteti serb është komuniteti më i madh etnik, komandantët e stacioneve policore dhe komandantët e nënstacioneve i emëron Ministria e Punëve të Brendshme me propozimin e Kuvendit Komunal dhe Drejtorit të Përgjithshëm. Kur pozita e Komandantit të Stacionit ose pozita e Komandantit të Nënstacionit lirohet, drejtori i Përgjithshëm duhet t'i dërgoj një kërkesë me shkrim Kuvendit Komunal në të cilën gjendet Stacioni ose nënstacioni policor në fjalë. Bashkë me kërkesën drejtori i Përgjithshëm është i obliguar të dërgojë edhe një listë me të gjithë kandidatët e përshtatshëm për pozitën. Më pas Kuvendi Komunal do të duhej të rekomandonte së paku dy kandidatë, të cilët i plotësojnë kriteret minimale. Brenda 15 ditësh pas pranimit të kërkesës Kuvendi Komunal do t'ia rekomandojë drejtorit të Përgjithshëm, së paku dy kandidat të cilët i plotësojnë kriteret minimale nga kjo listë dhe mund t'i rendis ata sipas preferencës. Brenda 15 ditësh drejtori pas pranimit të rekomandimeve do t'ia përcjellë Ministrisë së Punëve të Brendshme emrat e të gjithë kandidatëve të rekomanduar nga Kuvendi Komunal. Drejtori i Përgjithshëm mund ta shprehë preferencën e tij për emrat e rekomanduar nga Kuvendi Komunal. Ministria e Punëve të Brendshme do ta emërojë një kandidat nga emrat e rekomanduar brenda 15 ditëve nga dita e pranimit të listës”, përveç nëse aplikohet paragrafi 3 i këtij neni i cili thotë se: “nëse nuk përzgjidhet asnjëri nga kandidatët” dhe procedura të tjera. Këtë po e bëjë qëllimisht për shkak se ka kërkesa publike që të ndryshohet ky relacion dhe ju e dini se në Kosovë janë dy standarde të përzgjedhjes së komandantëve në stacionet policore, në komunat dhe emërimin tyre. Ky është vetëm një rekomandim MPB-së, ekipit i cili është në bisedime që ky kompromis i dhimbshëm të mos lëndohet edhe më shumë por përkundrazi të jenë konform Ligjit dhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Ka 14 vjet që është kjo gjendje, por ne duhet ta zgjidhim këtë gjendje dhe t'i instalojmë institucionet e Republikës së Kosovës në tërë territorin edhe në pjesën veriore dhe të funksionoj shteti ashtu si duhet. Nuk mund të flasim për gjendje normale të sigurisë nëse në një pjesë të territorit ekzistojnë edhe më tutje institucionet e një shteti tjetër, ekzistojnë veprime të cilat duan ta destabilizojnë Kosovën dhe nuk pranohet një marrëveshje e cila vjen nga një nivel ndërkombëtar më i

lartë në Evropë. Kjo e tregon më së miri gatishmërinë ose mosgatishmërinë e një shteti që t'i bëjë veprimet e duhura konform standardeve evropiane. Prandaj kërkesa jonë është që pala e Kosovës t'i bazohet Ligjit dhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Fatmir Xhelili- Problemi i asaj pjese nuk është problem kolateral, por është esenca e problemit dhe vetë bisedimet janë duke u zhvilluar për zgjidhjen e kësaj problematike. Qeveria e Kosovës e ka zgjedhur ekipin e mirë negociator i cili është i përgatitur dhe bazohet në Ligjet e Kosovës, në informatat të cilat i shkëmbejmë me partnerët dhe jam i bindur se Qeveria e Kosovës dhe ekipi negociator do të jetë brenda mandatit ligjor dhe kushtetues për format dhe mënyrat e zgjidhjes së problemeve. Normalisht se për këtë ata do të kenë parasysh edhe Ligjin e Policisë, por kryesisht bazë e kanë Kushtetutën e Kosovës dhe Kushtetuta nuk do të ndryshojë asgjë dhe e gjithë zgjidhja e pjesës veriore do të jetë në suaza të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Ligjeve të Kosovës.

Goran Marinković- Unë s'dua të flas se si do të përfundojnë bisedimet, por desha të them se ky proces është më rëndësi për të dy palët dhe se me këto bisedime do të zgjidhet një problem në veri i cili ekziston që 14 vite dhe normal që kjo nuk mund të rregullohet brenda natës pa marr parasysh se sa e dëshirojnë këtë njëra palë ose tjetra. Andaj mendoj që ky proces është në rregull dhe do të duhej të përfundoj dhe të gjendet një kompromis.

4. Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit Nr. 03/L-036 për Inspektoratin Policor të Kosovës

Kryetari i Komisionit- Mbikëqyrja e zbatimit të ligjit 03/L-036 për Inspektoratin Policorë të Kosovës. Jemi marrë vesh, si Komision që ta mbikëqyrim Ligjin për Inspektoratin e Policisë së Kosovës, për të cilin është formuar grupi dhe është punuar deri me tani, por konsideroj se është momenti që ta përfundojmë këtë proces dhe të kemi edhe një tryezë ku do ta shqyrtonim zbatimin e këtij Ligji, e në këtë mënyrë edhe reagimet të cilat po i kemi ndonjëherë në mënyrë sporadike dhe incidente individuale të shohim se sa po zbatohet nga Inspektorati Policorë i Kosovës dhe masat të cilat po merren nga Inspektorati.

Rexhep Selimi- Grupi punues ka filluar me punën e mbikëqyrjes së zbatueshmërisë së Ligjit të Inspektoratit të Policisë së Kosovës. Janë bërë kontaktet dhe vizitat e nevojshme përafërsisht për ato që ka pasur nevojë ky grup punues. Jemi në fazën përfundimtare të përpilimit të këtij Raporti. Raporti do të jetë së shpejti në Komision dhe në organet e nevojshme për këtë punë. E mbështesim organizimin e një tryeze dhe e shohim si të nevojshme, e cila do të ishte faza para finale e përpilimit të këtij Raporti përfundimtar. Ju njoftoj se jemi në fazën përfundimtare të kësaj mbikëqyrje. Do të ketë punë dhe pika të ndjeshme, por ndjeshmërinë ia ka shtuar kësaj çështje mos efikasiteti i këtij Inspektorati. Grupi punues së shpejti do ta përfundoj punën dhe do ta bëjë Raportin për Komisionin.

Anton Quni- Ndoshta është mungesë e përvojës tonë, por ne tani po flasim për një Raport duke u bazuar në një Mbikëqyrje të cilën ne e kemi bërë para disa muajve dhe tani riaktivizohet. Nga kjo distancë kohore ne po bëjmë Raport për aktivitetet tona prej së

paku para 5-6 muajve, kurse në këtë distancë kohore, Inspektorati i Policisë ka qenë i angazhuar në disa veprimtari të inspektimeve dhe hetimeve zyrtare të Policisë. Ndoshta tani është krijuar një realitet tjetër dhe nuk e di se sa do të jetë Raporti empirik dhe shkencor. Mendoj se përpos organizimit të tryezës, do të kishte qenë e udhës që edhe një herë ta vizitojmë Inspektoratin e Policisë, nëse ka të gjetura të reja, dukuri, fenomene, performanca e tyre etj., që ky Raport të jetë më i plotësuar.

Rexhep Selimi- Kjo vizitë përfundimtare është shumë e nevojshme, sepse ne edhe gjatë punës tonë nuk e kemi bërë këtë vizitë të fundit para Raportit. Nuk mund të bëhet Raporti pa e bërë edhe një vizitë duke i parë edhe një herë ato çfarë ne i kemi mbikëqyrë më herët dhe e kanë rrjedhën nga mbikëqyrja e fundit. Si vlerësim paraprak ka shumë çështje që edhe atëherë i kemi vizituar, që për fat të keq nuk e kanë humbur aktualitetin, nuk janë bërë të vjetra në kuptimin e mirë. Akoma janë çështje në Inspektoratin e Policisë dhe ato që kanë ndodhur dhe kanë pasuar më vonë do të jenë pjesë e këtij Raporti dhe ky Raport nuk do të mund të përfundohej pa ato që z. Quni iu referohet me rrjedhat e ngjarjeve të fundit dhe punën që e ka bërë Inspektorati. Tryeza do të jetë diçka e veçantë dhe jo e vetme, sepse Raporti nuk do të përmbillet para se të bëhet si gjithçka që është e mundshme dhe para se grupi punues të bëjë gjithçka që është e mundshme dhe e duhur për përpilimin e këtij raporti përfundimtar. Nuk kemi ndonjë linjë kohore e cila na kufizon që ne do të duhej ta bënim këtë Raport, sidoqoftë edhe komunitetin e mjaftueshëm e kemi harxhuar për shkak se është krijuar një fazë e gjatë e mbikëqyrjes së këtij Raporti. Kjo e ka anën e mirë dhe anën e keqe. Anën e mirë e ka se Raporti do të jetë më gjithëpërfshirës, do të jetë vetëm në një fazë të caktuar dhe do të përfshijë edhe ato që ka krijuar vonesa në këtë rast, por vonesa në këtë rast ka rrjedhur duke qenë komod në kohë dhe në anën tjetër Komisioni ka pas disa punë të tjera të cilat jo që e kanë nxjerrë nga prioriteti që e ka pasur ky raport, por të cilat kanë ndërhyrë në prioritetet që ka pasur Komisioni. Nuk mund të bëhet Raport pa parë dhe një herë se çfarë ka ndodhur nga vizita e fundit deri në momentin e përpilimit të Raportit.

Fatmir Xhelili- Nuk jemi duke e mbikëqyrë kualitetin e mënyrës së menaxhimit të punës së Inspektoratit, por ne jemi duke bërë mbikëqyrjen e Zbatimit të Ligjit, mos po shkelet Ligji ose Udhëzimet Administrative, mos po shkelen pozitat administrative zyrtare. Periudha kohore mund të jetë hendikep, por edhe përparësi sepse na jep mundësi për t' i fokusuar dhe identifikuar shkeljet eventuale të Inspektoratit. Lus administratën që javën e ardhshme ta organizojë një takim me grupin punues për mbikëqyrjen e Financave Publike ose së paku një kontakt me ekipin e Auditorit.

Kryetari i Komisionit- Brenda muajit prill kishte qenë mirë me përfunduar këtë proces sa i përket zbatimit të Ligjit të Inspektoratit të Policisë së Kosovës. Është mirë ta kemi edhe vizitën, sepse mund të jemi më të përafërt me rrjedhat e mëvonshme në Inspektoratin e Policisë, por duhet ta përfundojmë si proces në mënyrë që ta kemi një Raport të kompletuar. Po ashtu edhe sa i përket çështjes së Financave Publike, do të ishte mirë që të bëhet sa më shpejt për shkak të angazhimit në punët tjera që i kemi si Komision.

5. Të ndryshme

Kryetari i Komisionit- Dua të ju njoftoj rreth vizitës që kam pasur në Bruksel në bazën e NATO-s dhe angazhimet tona që i kemi pasur edhe në emër të Komisionit, Ministrisë së FSK-së, po ashtu kanë marrë pjesë edhe këshilltari i Presidentes, këshilltari i Kryeministrit. Ka qenë një angazhim i yni në bazë të agjendës për vendet të cilat aplikojnë për inkuadrimin në NATO. Kemi vizituar edhe një bazë ku bëhet angazhimi për vendet të cilat duan të inkuadrohen në NATO, procedurat, mënyrat e aftësimit të ushtrive të vendeve të cilat vetëm garantojnë Sigurinë. Jemi pritur shumë mirë dhe ka pasur bisedime rreth Misionit të FSK-së dhe vlerësimeve që duhet të bëhen tani në qershor deri në fund të vitit, sepse duhet të ndërrohet edhe Misioni i FSK-së dhe jepet drita e gjelbër që në të ardhmen të kalojë në një Mision ushtarak që një ditë do të garantojë siguri në vend dhe Rajon. Jemi njoftuar me procedurat e tilla, madje kemi vizituar edhe zyrën e Shqipërisë e cila është në NATO. Na njoftuan për angazhimet e tyre edhe në vendet e tjera për të krijuar paqen.

Njoftim tjetër është se javën e ardhshme në Kosovë vjen ministri i Mbrojtjes së Maqedonisë, z. Taulant Xhaferi. Ka kërkuar një takim me Komisionin më 19.04. 2013 në orën 11. Është mirë të jemi prezent gjithë anëtarët e Komisionit, meqë kemi të bëjmë me një ministër të vendit fqinjë e që mund të shkëmbejmë edhe përvojat rreth funksionimit të Komisionit atje.

Sipas kalendarit të angazhimeve, e kemi shqyrtimin e Raportit Vjetor të Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale që e kemi paraparë për muajin prill. Duhet të përgatitemi dhe të kemi një angazhim tonin si Komision. Po ashtu një vizitë e paraparë është në Policinë e Kosovës, dhe vizitën në Qendrën e Situatave. Këto kanë qenë të parapara në bazë të kalendarit të punës që e kemi. Njëkohësisht dua të ju njoftoj se pas takimit që kam pasur me drejtorin e AKI-së, kam kërkuar nga ai që të na jap një sugjerim se a duan ata ta tërheqin Ligjin përgjimet apo duan që Komisioni ta vazhdoj punën? Cili është vendimi i tyre, por ende nuk kemi një deklaram apo njoftim nga ana e drejtorit të AKI-së? Mirëpo do të kërkoj që të na njoftojë dhe të na japë së paku një zgjidhje të cilën e mendojnë, pastaj ne, si Komision, do të vendosim.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi